

05/12/2025

Konferencën e Parë Shkencore Ndërkombëtare “Shqipëria në periudhën bizantine”



TIRANË, 5-6 DHJETOR 2025

Nga datat 5-6 dhjetor po zhvillohet në Tiranë Konferenca I Shkencore Ndërkombëtare “Shqipëria në Periudhën Bizantine” organizuar nga:

Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë

Akademia e Shkencave e Shqipërisë

Universiteti i Tiranës – Fakulteti i Historisë dhe i Filiologjisë

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave

Shoqata Shqiptare e Studimeve Bizantine me pjesëmarrjen e Fortlumenturisë së Tij Kryepiskopit të Tiranës, Durrësit dhe Gjithë Shqipërisë imzot Joanit, përfaqësues nga bota akademike brenda dhe jashtë vendit, historianë dhe profesorë të njohur.

Fortlumenturia e tij imzot Joani referoi kumtesën e tij me temë: “Nga Iliriku në Bizant dhe deri më sot: Kisha si një urë e gjallë besimi dhe qytetërimi”

Konferenca po zhvillohet ditën e sotme në ambientet e Hotel International dhe ditën e nesërme në ambientet e Akademisë së Shkencave.

5 dhjetor 2025

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)